



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

VENDIM

Nr 10 , Datë 26.09.2013

Për
Miratimin e projekt-idesë për "Rehabilitimin e disa digave ekzistuese
të Koshnicë-1, Leminot".

Në zbatim të pikës dh. neni 4, kreu II, të ligjit nr.8681, datë 02.11.2000, "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin, dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", neni 8, 13, të "Rregullores për sigurinë e digave dhe dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) dhe Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD), me kërkesë të Ministrisë së Bujqësisë Ushqimit e Mbrojtjes së Konsumatorit me shkresën nr.3826 prot, date 16.09.2013 në mbledhjen e datës 18.09.2013, mori në shqyrtim projekt-idenë për "Rehabilitimin e digave ekzistuese të Koshnicës-1 dhe Leminotit", nga projekti i Burimeve Ujore dhe Ujitjes, i financuar nga Banka Botërore dhe Qeveria Shqiptare.

Mbasi u prezantua projekt-ideja nga përfaqësuesit e grupit të projektimit Mott MacDonald në datë 13.09.2013 si dhe diskutimi nga anëtarët e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha,

Vendosi:

Të miratojë projekt-idenë për "Rehabilitimin e digave ekzistuese të Koshnicës-1 dhe Leminotit", duke sugjeruar sa më poshtë :

Për digën e Koshnicës-1, për fazën e projekt-zbatimit duhet:

1. Të kryhen disa punime shtesë në trupin e digës ku të analizohet më mirë gjëndja e dherave, nga natyra e tyre.
2. Të kryhen disa përcaktime të tjera si, pesha volumore e skeletit, poroziteti, koficenti i filtrimit, të bëhet prova "Proktor" për përcaktimin e parametrave optimal që mund të arrihen me këto dhera dhe për të krahasuar ato me ato që janë arritur konkretisht në këtë digë.
3. Të përcaktohet më saktë plani i shkarjes, sikurse dhe mundësia e riparimit të këtyre dherave për digën e re.

4. Të bëhet një analizë e përbërjes mineralogjike të këtyre dherave, ku në dukje vihet re se përmbajnë minerale mike dhe a`ndikon prania e tyre në cilësinë e dherave të digës.
5. Në fazën e zbatimit të punimeve të përcaktohet shkalla e ngjeshjes së dherave me "prova" të dokumentuara dhe kontrolluara.

Me respekt,

PERI DISHNICA

KRYETAR

